



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Lulishtja Buçaj” Sh.P.K. të datës 14.07.2025 kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Progovc” me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Lulishtja Buçaj” Sh.P.K. të datës 14.07.2025 kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Progovc” me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1 ashtu që **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i datës 07.07.2025 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Arsyetim

Operatori ekonomik “Lulishtja Buçaj” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 14.07.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Progovc” me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i AK që në ofertën tonë nuk është prezantuar pajisja në fjalë është tërësisht i pasaktë pasi që sipas kërkesës së DT ne kemi dorëzuar dëshmitë edhe për këtë pajisje të cilën si të tillë e kemi evidentuar në listën e pajisjeve (përndryshe edhe në rastin kur nuk do të ishte dorëzuar dëshmia përkatëse, për faktin që pajisja evidentohet në listë AK detyrohet që të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP). Sidoqoftë, në vijim po ju prezantojmë dëshmitë përkatëse të cilat mund t'i gjeni edhe në dokumentet e prezantuara në ofertën tonë (shih dokumentin me nr. 4. Lista e mjeteve fq. 7, 8 dhe 9).



KONTRATË PËR QERANË E PAJISJEVE

1. Geo-mineral SH.P.K. me NUI: 810316324 me seli në nusen Hajrudin Abdullahu Prishtinë i përfaqësuar nga Kujtim Hashani.
2. N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ" me NUI: 810718075 me seli në Gushericë e URB-Graçanicë e përfaqësuar nga z. Pleurat Duçaj.
3. Palët bëjnë kontratë për qerandhënie të pajisjes për tenderin me titull: "Ndërtimi i parkut sportiv dhe kendit të lodrave në lagjen 5-Prugov" me nr. prokurimit: 616-25-1614-5-2-1 publikuar nga Kuvendi i Komunes së Prishtinës.

Neni 1

Palët janë pajtuar që Geo Mineral SH.P.K. t'i jap me qera për N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ" njetet që i posedon si më poshtë për kryerjen e projektit nga N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ".

Nr.	Nr. i regjistrimit	Emri i njetit	Lloji i njetit
1	01-394-EV	Autobetonierë mikser me dy dyer	MAN

Neni 2

Pajisjet sipas nenit 1 të kësaj kontrate lihen me qera duke filluar nga data e nënshkrimit e deri në përfundim të kontratës me titull: "Ndërtimi i parkut sportiv dhe kendit të lodrave në lagjen 5-Prugov" me nr. prokurimit: 616-25-1614-5-2-1

Neni 3

Pagesa për huazimin e njetëve sipas nenit 1 në fjalë do të bëhet pas fillimit të inkasimit të njetëve nga investitorët sipas marrëveshjes së dy palëve në një marrëveshje të veçantë.

Neni 4

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në mes të palëve kompetente është Gjykata Themelore.

Arsyet eliminuese të parashtruesit sipas letrës standarde janë si në vijim:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju si OE-ik nuk keni oferte të përgjegjshme për arsyet se GOE-ik me ofertën e tij nuk ka dorëzuar sipas kërkesës së DT-se dhe njoftimit për kontratë:

pika 4. i) 1(Një) automikser për prodhimin e betonit (me regjistrim valid)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Një listë të mjeteve apo pajisjeve teknike që jeni në dispozicionin tuaj për të ekzekutuar kontratën në fjalë- pajisjet dhe makineria në dispozicion duhet të dëshmohen me kopje të librezave nipi pronësinë e tyre ose DUD-i doyanar. Në rast të marrjes me qera duhet të dëshmohet edhe me kontratë mbi qiramarrjen për këtë projekt, ju me ofertën tuaj keni paraqitur pajisje tjetër në kundërshtim, për këtë arsye oferta e juaj është e pa përgjegjshme.

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore është gjetur se komisioni vlerësues nuk ka vepruar në përputhje me nenin 59 par. 4 si dhe nenin 62 të LPP me rastin e vlerësimit të ofertave lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të pjesërisht qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 17.07.2025

Visar SHEHU



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.